

[BERAT BILALLI - ZAMAN SHQIP]

■ NAZMI MALIQI, ANALIST DHE DEKAN I SHKENCAVE POLITIKE NË UNIVERSITETIN FON



NEVOJA PËR NJË PROKUROR SPECIAL JEP NJË PAMJE SE MAQEDONIA, PO RRUGËTON DREJT NJË PROTEKTORATI JURIDIK

Kuptimin e ndërtimit të shtetit, subjektet politike të Republikës së Maqedonisë mund të llogarisin vitet e fundit, si një periudhë me shumë lëshime dhe dështime. Pas 24 viteve demokraci, të jetës shumë partiake, të garave të ndryshme, thirrjes në politikë e integritimit për në Bashkimin Evropian dhe NATO, duke i pranuar ato standarde për anëtarësim, duke shkuar prej harmonizimit drejt unifikimit të atyre standardeve, Republika e Maqedonisë u gjet në një udhëkryq që janë specifika të veçanta të sistemeve të dështuara që ndodhin në ndërtimin e një shteti. “Prokurorja speciale Katica Janeva, duhet të hyjë në tërësinë e vlerave kualitative që e përbëjnë sistemi juridik, si do të ndërtohet shteti ligjor, si do të funksionojnë ligjet, si do të ndiqet kriminaliteti, si do të pastrohen çështjet që kanë të bëjnë me shkeljen e ligjeve edhe nga vet qeveria. Nevoja për një Prokuror special jep një pamje se Maqedonia, po rrugëton në një protektorat juri-

dik ose një protektorat me pushtetin gjyqësor. Si ndodhi partizimi i skajshëm i institucioneve shtetërore, shkatërrimi i bizneseve, privatizimi jo ligjor, rritja e varfërisë, papunësia, plaçkitjet të pronave shtetërore etj. E gjithë kjo është katalizator i rëndësishëm i krijimit të fundamentit të kriminalitetit të organizuar. Mos zbatimi i ligjit, qytetarët e shtresave, moshave, etnive të ndryshme, i solli në pozitë të pasigurisë dhe pa perspektivës. Kësaj frike për çdo ditë i shtohet shqetësimi, se shteti është në një dërrë të pushtetit pa drejtësi dhe drejtësisë pa pushtet. Kjo dëshmon se partitë politike maqedonase të ndihmuara nga ato shqiptare në politikë bërje, nuk u paraqitën vigjilent për të krijuar institucione stabile.”, theksoi Prof. Dr. Nazmi Maliki.

NDËRKOMBËTARËT DHE QYTETARËT PRESIN QË MAQEDONIA TË DEBLLOKOHET NGA VLERAT SOCIO PATOLOGJIKE

Paraqiten shumë dilema se si do të funksionojnë më tej, cilat do të jenë efektet e prokurorit special, duke i bartur ato kompetencat ligjore që i janë dhënë. ■■■■

Nëse Prokurorja speciale me anëtarët e prokurorisë do të luaj rolin vigilent të respektimit të normave dhe ligjeve, si dhe etikës ligjore, mendoj se do të ketë efekte pozitive ku të dy partitë kanë gjetur një gjuhë të përbashkët për këtë person. “Ti lëmë anësh të gjitha këto dilema, por çështja kryesore është se si kanë mundur të arrijnë gjuhën e përbashkët partitë politike për një person të njëjtë. Kjo mbetet një dilemë intelektuale, akademike, ky person a ka qenë figurë e respektuar në pushtetin gjyqësor. Ndërkombëtarët dhe qytetarët presin që Maqedonia të deblloket nga vlerat sociopatologjike si rrënuese të institucioneve të shtetit, të krijohet një realitet se Maqedonia po garon për vlera demokratike, për ta bërë vendin një shtet stabil drejt BE-së dhe NATO-së”, bëri të ditur Maliqi.

TË GJITHA RASTET QË DYSHOHEN DHE LIDHEN ME KRIMIN E ORGANIZUAR DO TË JENË PJESË E AGJENDËS SË PROKURORIT SPECIAL

Respektohet vija e kontrollit dhe përfaqësuesit të Prokurorit Special. Tek ekipi i prokurorit special 25% do jenë shqiptarë, veç këtyre do të ketë edhe anëtarë nga ndërkombëtarët dhe pjesa tjetër do jenë etnitetit maqedonas dhe etniteteve tjera. Sipas dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike në Universitetin Fon në Shkup, dr. prof. Nazmi Maliqi, politika e përfshirë në kriminalitet të organizuar jo vetëm pse i venë në pikëpyetje vlerat demokratike dhe vlerat njerëzore, por krahas këtyre devijime mund të vë në pikëpyetje stabilitetin dhe ekzistimin e shtetit. Sipas Ligjit për prokurorin special, është shumë me rëndësi të mos mungoj llogaridhënia. Ajo do të raportojë para deputetëve të Maqedonisë, dhe mënyra e raportimit brenda prokurorisë ka krijuar një element shumë të fuqishëm të llogaridhënies. Afatet e papaparë që duhet të shtjellohet puna e prokurores speciale, dhe brenda 18 muajve duhet të përfundoj procesi i rastit të përgjimeve, rastit “Puç” dhe lëndëve të tjera të cilat do të jenë në fokus. Mandati i prokurorit është 4 vite, ku me një elaborim dhe projekt të qëndrueshëm mund të kthehet besimi në gjyqësinë e Republikës së Maqedonisë. “Gjykatat nuk kanë mundur ta kryejnë detyrën nga bllokimi partiak, kjo ishte edhe arsyeja për një prokuror tjetër që e simbolizon në një farë mënyre pavarësinë e gjyqësorit. Të gjitha rastet që dyshohen dhe lidhen me krimin e organizuar do të jenë pjesë e agjendës të prokurorit special. Ashtu si shkuan bisedimet, u krijua përshtypja se partitë shqiptare nuk ishin të rëndësishëm në këtë proces, ato nuk kishin projekt të vetin me qasje serioze, ato shprehnin pajtim here me njëherë e herë me tjetrën parti maqedonase”, citoi Maliqi.

SUKSESI I PROKURORIT SPECIAL DO TË VARET EDHE NGA PUNA E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME

Ministri i punëve të brendshme mund të jetë figura kyçe, se a do të ketë apo jo sukses prokurori special. “Kemi një element të kontrollit të mjaftueshëm, ku nëse partitë politike kanë arritur një pjekuri apo vigjilencë, ku shteti duhet të shkojë drejt një stabiliteti institucional për t’i pranuar politikën e mirëqenies ekonomike, sociale që u mungojnë qytetarëve të Maqedonisë. Të sqarojmë një fakt, nëse sistemi elektoral është nënsistem i fuqishëm i sistemit politico - ju-

ridik, apo pjesa më e rëndësishme e tij, atëherë nuk mund të bëhet fjalë për rend juridik ligjor, apo politikë bërje ligjore në shtet, dhe nëse shkelen rregullat ligjore zgjedhore, prej ku edhe fillon baza e themelimit të shtetit nuk është në rregull. Nëse krimi i organizuar i elitave të partive politike fillon nga kutitë e votimit, me vota të vjedhura, me vota të manipuluar, elitat politike pushtetarë i mundësojnë, individëve të involvuar në strukturat e ndryshme udhëheqëse shteti dhe shtetërore të shohin rastin e përfitimeve dhe shlyerje të gjurmëve të keqpërdorimit apo të kriminalitetit. Pra këtu kemi të bëjmë me pasurime të çuditshme të njerëzve. Kjo shkelje e ligjit zgjedhor me vite po ndodhë në Republikën e Maqedonisë. Me politikën kriminale, politikën që kanë ngjyrim socio patolojik shprehin pesimizëm të qytetarët, apati, apo edhe ndjenja e frikës dhe largim nga shteti. Me këtë marrëveshje të ndikuar nga përfaqësues të BE-së ndaj katër partive, VMRO - DPMNE, BDI, LSDM dhe PDSH, qytetarët presin që këta aktor partiak ta hetojnë shtetin e tyre, tu kthejnë besimin votuesve se mund të funksionoj ligji. Duke u bazuar nga e kaluara mund të na përcjell një pesimizëm ku edhe marrëveshja kornizë e Ohrit ka qenë një dokument i rëndësishëm për të funksionuar një shtet stabil, për gjithë atë frymë që e ofron Marrëveshja e Ohrit. Porosia e Marrëveshjes së Ohrit, për fat të keq, nuk është futur në praktikë të aktorëve politik, mirëpo ne nuk duhet të ndërtojmë një pesimizëm të skajshëm që të mendojmë ashtu edhe për këtë proces që po ndodh tani, tha Maliqi.



NËSE DO TË KEMI RASTE TË RRUMBULLAKIMIT TË LËNDËVE DHE POSEDHET FAKTO-GRAFI ATËHERË MENDOJ SE EDHE DISA PREJ KËTYRE POLITIKANËVE AKTUAL NUK DO TË MUND TË GAROJNË

Këtë prokuror special sipas asaj që mendoj unë, e kanë propozuar partitë. Dy liderët janë pajtuar për të njëjtin emër, me siguri ka pasur edhe kombinime tjera që i ka shtyrë që kjo të zgjidhet. “Kompetencat janë shumë të mëdha dhe nëse i hyhet me seriozitet, dhe kthehet besueshmëria e qytetarëve tek pushteti gjyqësor atëherë kjo është një zgjedhje shumë e mirë. Zbardhja e të gjitha lëndëve të pazgjidhura, të anashkaluar, të pluhurosura me vite, që kanë qenë kancerogjene në sistemin politiko - juridik të shtetit, mund të krijojë hapësira shumë më të mira për ti besuar shtetit. Nëse do të kemi raste të rrumbullakimit të lëndëve dhe posedohet fakto-grafi atëherë mendoj se edhe disa prej këtyre politikanëve aktual nuk do të mund të garojnë më tutje në politikë bërje. Në respektimin e porosive të kësaj marrëveshjeve fitojnë të gjithë dhe më shumë fitojnë aktorët e këtij dokumenti. Po të ndodh diçka e mirë, kanë qenë ato aktorë të kësaj marrëveshje. Do të ishte sukses nëse kjo prokurorë do të ketë një guxim profesional dhe të luajnë rolin pozitiv, e ka rastin të hyjë në histori. Nëse nuk janë të vetëdijshëm fytyrat politike se kjo marrëveshje ju hap një rrugë të suksesshme në biografitë e tyre, atëherë mund të përsëriten edhe gabimet e Marrëveshjes së Ohrit edhe të mos zbatimit të porosive që çdo vit i jep BE-ja. Republika e Maqedonisë, që nga viti 2005 është shtet kandidat për anëtarësim në BE-, mirëpo 10 vite mos lëvizje nga ai status tregon gjendjen aktuale të vendit”, përfundoi dr. prof. Nazmi Maliqi.